

INSTRUMENTI 6: EVIDENTIMI I FËMIJËVE JASHTË SHKOLLE DHE NXËNËSIT QË E KANË BRAKTISUR SHKOLLËN

Përmbledhja:			
Instrument për	Komunat	Synimi:	Evidentimi i informatave për fëmijët jashtë shkolle dhe fëmijët, të cilët e kanë braktisur shkollën, me qëllim që të realizohet një monitorim më i mirë
Procesi	Komuna i mban të centralizuara të dhënat për fëmijët jashtë shkolle dhe nxënësit, të cilët e kanë braktisur shkollën. Komunat i monitorojnë rastet, në bazë të informatave në dispozicion.		

Lista kontrolluese	✓
Komuna i mban të dhënat individuale të fëmijëve jashtë shkolle dhe të nxënësve, të cilët e kanë braktisur shkollën	
Komuna cakton një person kontaktues përgjegjës për centralizimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të përditësuara	
Komuna i evidenton ndërhyrjet për parandalim dhe reagim, të identifikuara për fëmijun	
Komuna e evidenton përparimin dhe rezultatet e ndërhyrjeve parandaluese dhe reaguese për fëmijën	
Komuna dhe EPRBM-të bashkëpunojnë me të gjithë akterët përkatës për të mbështetur riintegrimin e fëmijës në shkollë	
Komuna ka një mekanizëm në funksion për të njoftuar policinë dhe Qendrën për Punë Sociale, kur ka shqetësime serioze për sigurinë e fëmijës jashtë shkolle	
Komuna analizon të dhënat vjetore për fëmijët jashtë shkolle, në mënyrë që të ketë njohuri më të mira për profilin e këtyre fëmijëve	
Komuna përdor të dhënat për fëmijët jashtë shkolle për identifikimin e lokacioneve/ shkollave, ku problemi duhet të trajtohet me prioritet	
Komuna monitoron tendencat e fëmijëve jashtë shkolle për një periudhë të caktuar kohore, në mënyrë që të identifikojë se çfarë ndërhyrje janë më të suksesshme për kthimin e sërishëm të fëmijëve në shkollë	